

Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Universiteti Polis shpk është krijuar më 30/03/2006 me nr. Vendimi 35386 date 04/04/2006. Misioni i Shoqërisë është themelimi i Shkollës Ndërkombëtare të Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban, e cila përbëhet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizanjit dhe Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban.

NIPT-i i Shoqërisë është K62308008S. Selia e shoqërisë ndodhet në autostradën Tiranë-Durrës, km 5 Kashar, Tiranë.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 Lekë dhe zotërohet nga ortakët:

- Dritan Shutina 25% të kuotave
- Gazmend Haxhia 25% të kuotave
- Besnik Aliaj dhe 25% të kuotave
- Sotir Dhamo 25% të kuotave

Në 31 dhjetor 2020 shoqëria 147 ka punonjës. (2019: 135 punonjës)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.



2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/Lek	123.70	121.77
USD/ Lek	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë


Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përfaqësohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet nëpasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa, instalime	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera embetur	20%
Pajisje informatike	Vlera embetur	25%
Mobilje zyre	Vlera embetur	20%
AAJM	Vlera fillestare	15%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitim të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për llogaritjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i arsyeshmë shumës së humbjes.



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	74,167,973	75,298,625
Në Lekë	1,141,298	850,358
Në monedhë të huaj	73,026,675	74,448,267
Mjete monetare në arkë	1,092,281	3,013,291
Në Lekë	958,838	910,474
Në monedhë të huaj	133,443	2,102,817
	<u>75,260,254</u>	<u>78,311,916</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Klientë për mallra e shërbime	7,658,495	6,859,069
	<u>7,658,495</u>	<u>6,859,069</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Motown sh.p.k	3,963,104	3,963,105
Metropolis sh.p.k	2,345,790	2,316,524
Zhvlerësim i të arkëtueshmeve	(1,826,726)	-
	<u>4,482,168</u>	<u>6,279,629</u>



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
TVSH për t'u arkëtuar	-	16,519
Debitorë të ndryshëm	535,229	512,870
Tatim fitim parapaguar	-	2,243,286
	<u>535,229</u>	<u>2,772,675</u>

8. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mallra (Libra)	3,963,933	3,210,390
	<u>3,963,933</u>	<u>3,210,390</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme	9,071,536	7,362,860
	<u>9,071,536</u>	<u>7,362,860</u>



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Mobilje e pajisje zyre	Të tjera	Totali
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2019	58,199,364	24,368,803	662,500	34,829,512	38,848,559	15,906,129	172,814,867
Shtesa	1,325,184	733,255	-	7,567,855	3,535,915	256,839	13,419,048
Gjendja më 31 dhjetor 2019	59,524,548	25,102,058	662,500	42,397,367	42,384,474	16,162,968	186,233,915
Shtesa	1,891,181	1,991,464	-	432,765	199,350	66,144	4,580,904
Gjendja më 31 dhjetor 2020	61,415,729	27,093,522	662,500	42,830,132	42,583,824	16,229,112	190,814,819
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2019	19,673,503	15,369,158	582,474	26,946,805	27,850,210	7,100,034	97,522,184
Amortizimi i vitit	1,926,293	1,823,402	16,005	3,035,045	2,408,409	441,308	9,650,462
Gjendja më 31 dhjetor 2019	21,599,796	17,192,560	598,479	29,981,850	30,258,619	7,541,342	107,172,646
Amortizimi i vitit	1,896,238	1,766,104	12,804	3,285,895	2,371,356	384,611	9,717,008
Pakësime							-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	23,496,034	18,958,664	611,283	33,267,745	32,629,975	7,925,953	116,889,654

Vlera neto kontabël

Gjendja më 31 dhjetor 2019	37,924,752	7,909,498	64,021	12,415,517	12,125,855	8,621,626	79,061,269
Gjendja më 31 dhjetor 2020	37,919,695	8,134,858	51,217	9,562,387	9,953,849	8,303,159	73,925,165



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

11. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2019	1,684,487	1,684,487
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,684,487	1,684,487
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,684,487	1,684,487
Zhvlerësimi akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2019	610,626	610,626
Zhvlerësimi i vitit	252,673	252,673
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	863,299	863,299
Zhvlerësimi i vitit	252,673	252,673
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,115,972	1,115,972
Gjendja neto më 31 dhjetor 2019	821,188	821,188
Gjendja neto më 31 dhjetor 2020	568,515	568,515

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Furnitorë	580,500	1,600,221
Furnitorë për fatura të pambërritura	230,332	284,051
	810,832	1,884,272



Universiteti Polis sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lek)

16. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Paga për t'u paguar	-	489,667
Shteti – TVSH e pagueshme	208,399	-
	<u>208,399</u>	<u>489,667</u>

17. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime afatgjata ndaj ortakëve	36,988,056	38,890,442
	<u>36,988,056</u>	<u>38,890,442</u>

18. Grante

Grantet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Grante për aktivet afatgjata materiale	24,121,623	26,192,073
Grante për aktivet afatgjata materiale për projektet	11,517,335	47,347,777
	<u>35,638,956</u>	<u>73,539,850</u>



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

19. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 Lekë. 25 kuota zotërohen nga ortaku Dritan Shutina, 25 kuota nga ortaku Gazmend Haxhia, 25 kuota nga ortaku Besnik Aliaj dhe 25 kuota zotërohen nga ortaku Sotir Dhamo:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale (në Lek)	1,000	1,000
Kapitali	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>

Fitimi i mbartur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 ishte 22,360,142 ALL. (2019: 15,624,557 ALL)

Fitimi i ushtrimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 ishte 6,912,352 ALL. (2019: 6,735,585 ALL)

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga tarifat shkollore	234,085,808	235,604,007
	<u>234,085,808</u>	<u>235,604,007</u>

21. Të ardhurat e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga nën-qeraja	603,945	2,216,955
Të ardhura nga grantet	13,408,630	11,261,370
Të ardhura nga kancelaria dhe aktivitetet	674,933	1,318,996
Të ardhura të tjera	5,715,736	4,034,771
Te ardhura nga kompensimi detyrimeve tatimore	-	4,057,616
Të ardhura (Shpenzimet) nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare neto	818,053	(1,105,979)
	<u>21,221,297</u>	<u>21,783,729</u>



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

21. Të ardhurat e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2020</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	263,340,003
Shtohen parapagimet në çelje	38,847,003
Zbriten parapagimet në mbyllje	(48,814,941)
Ndryshimet në grante	2,749,827
Falje detyrimi	-
Efekti kursit të këmbimit	818,053
Te ardhura tatimore	(1,632,840)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	255,307,105
Sipas Kontabilitetit	255,307,105
Diferenca	-

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime qeraje	39,881,850	44,334,000
Blerje energji, avull, ujë karburant	2,982,489	4,003,172
Kancelari dhe botime	1,007,353	2,180,505
Shpenzime internet	334,548	399,863
Shpenzime transporti	1,266,460	1,273,500
Konsulence	384,000	1,008,000
Konferenca dhe projekte	13,293,580	17,060,264
Honorare	5,644,315	7,111,032
Shpenzime reklame	1,148,923	3,058,787
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	418,068	546,369
Mirembajtje dhe riparime	236,382	443,858
Shpenzime pastrami	431,306	758,396
Sherbime bankare	457,539	391,016
Shpenzime te tjera	6,271,835	6,389,166
Tatime dhe taksa	284,200	276,754
	74,042,848	89,234,682



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime paga	140,297,777	132,349,297
Shpenzime për sigurime shoqerore	19,218,213	17,641,590
	<u>159,515,990</u>	<u>149,990,887</u>

24. Shpenzimezhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime amortizimi	9,969,681	9,903,135
	<u>9,969,681</u>	<u>9,903,135</u>

25. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interes, ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për interesa	-	24,103
	<u>-</u>	<u>24,103</u>



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

26. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<i>Fitimi para tatimit</i>	9,951,860	8,234,929
Total shpenzime të panjohura	10,311,528	1,760,700
Shpenzime per pritje percjellje		
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	1,000	
Humbje nga shitja e AAM		
Shpenzime të tjera	8,677,688	5,818,316
Te ardhura nga qiraja e zhvleresuar	1,632,840	-
Të ardhura të patatueshme nga kompensimi i detyrimeve tatimore	-	(4,057,616)
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	20,263,388	9,995,629
Humbje fiskale e mbartur		
Fitimi i tatueshëm	20,263,388	9,995,630
Tatim fitimi @15%	3,039,508	1,499,344
	6,912,352	6,735,585

27. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura gjatë vitit 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Metroplis sh.p.k	2,345,790		2,316,524	
Motown sh.p.k	3,963,105	138,400	3,963,105	600,000
	6,308,895	138,400	6,279,629	600,000

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Motown sh.p.k	1,491,190	-	1,477,970	600,000
Metropolis sh.p.k	149,119	-	450,257	-
	1,640,309	-	1,928,227	600,000



Universiteti Polis sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

28. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë te pasqyrat financiare

